



Sheshi Nëna Terezë · Hyrja I · 59A · Nr.10
Pristina 10000, Kosovo
T/F: +381 38 746 206
E: ridea.institute@gmail.com

Manor Road
Oxford OX1 3UQ
United Kingdom
T: +44 (0)1865 278700
F: +44 (0)1865 278725
E: cis@politics.ox.ac.uk

RAPORT HULUMTUES

Konsolidimi i shtetësisë së Kosovës: Proceset, Problemet, Perspektivat

**Prishtinë
Tetor 2012**

Përkrahur nga:



Copyright © Tetor, 2012 – Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA) dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare (Universiteti i Oksfordit)



RAPORT HULUMTUES

Konsolidimi i shtetësisë së Kosovës: Proceset, Problemet, Perspektivat

Përmbajtja:

<i>i.</i>	SFONDI I RAPORTIT.....	4
<i>ii.</i>	OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT.....	5
<i>iii.</i>	STRUKTURA E RAPORTIT.....	6
I.	A PO AFROHET FUNDI I LOJËS NË VERIUN E KOSOVËS? ALTERNATIVAT DHE SKENARET PËR ZGJIDHJEN E REBUSIT NË VERIUN E KOSOVËS.....	7
	I.1. Sfondi i rebusit në veri të Kosovës.....	7
	I.2. Mjetet e analizës.....	8
	I.3. Skenarët e mundshëm për zgjidhjen e rebusit në veri të Kosovës.....	10
	I.4. Përfundime.....	13
	I.5. Rekomandime.....	13
II.	NJOHJA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS: PERSPEKTIVA ‘INVENTARIZUESE’ DHE E ‘SHIKIMIT PËRPARA’	19
	II.1. Një vlerësim krahasues: Kosova dhe të tjerët.....	20
	II.2. Njohja: Vlera dhe Rëndësia që ka për Shtetësinë.....	21
	II.3. Përfundime.....	23
	II.4. Opsione Politike dhe Rekomandime.....	24
	SHTOJCA	26

i.SFONDI I RAPORTIT

Në përgjithësi, shtetësia ka dy dimensione: atë të brendshëm dhe të jashtëm. Republika e Kosovës, shteti më i ri në Evropë, shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Gjykuar në bazë të rrethanave të saj të veçanta, Kosova ka arritur përparim përmbajtësor në adresimin e që të dy dimensioneve të shtetësisë. Gjithsesi, deri te konsolidimi i shtetësisë së Kosovës, në aspektin e brendshëm dhe të jashtëm, akoma mbesin edhe shumë sfida të rëndësishme për t'u adresuar.

Sa i përket dimensionit të jashtëm të shtetësisë, deri më sot Kosova është njohur nga më shumë se 90 shtete, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe shumicën dërmuese të shteteve të Bashkimit Evropian (BE). Po ashtu, Republika e Kosovës ka arritur që të anëtarësohet në organizata të rëndësishme ekonomike ndërkombëtare, si Banka Botërore (BB) dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), që të dyja këto agjencione të specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Mirëpo, akoma mbesin sfida për t'u adresuar deri në realizimin e plotë të dimensionit ndërkombëtar ose të jashtëm të shtetësisë së Kosovës. Për shembull, Kosova akoma nuk njihet nga 5 shtete anëtare të BE-së. Për më shumë, Kosova nuk është shtet anëtar në OKB apo organizatat e tjera relevante rajonale dhe ndërkombëtare (si Këshilli i Evropës [KiE], Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë [OSBE]) dhe, në bazë të rrethanave aktuale politike ndërkombëtare, një gjë e tillë nuk pritet të ndodhë së shpejti. Kësisoj, kjo hyrje e shkurtër parashtron një mori pyetjesh me rëndësi, ku mbase pyetja më me rëndësi është: Si duhet të adresohet çështja e konsolidimit të shtetësisë së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare nga ana e institucioneve të vendit? Me fjalë të tjera, çfarë duhet të bëhet në mënyrë që Kosova të bëhet anëtare e plotë e bashkësisë ndërkombëtare të shteteve?

Sa i përket konsolidimit të shtetësisë së brendshme, në këtë rrafsh është arritur përparim përmbajtësor. Përparimi mund të vërehet para së gjithash në raport me masat e ndërmarra dhe rezultatet e arritura në adresimin e nevojave të komuniteteve pakicë. Për shembull, komuniteti serb në Kosovën qendrore dhe jugore ka filluar të integrohet në institucionet

lokale dhe qendrore të shtetit të Kosovës. E njëjta vlen edhe për komunitetet e tjera që jetojnë gjithandej Kosovës. Pa dyshim, ky përparim mund të konsiderohet përmbajtësor. Gjithsesi, ana tjetër e mozaikut ka të bëjë me problemet dhe sfidat e vazhdueshme, që gjithashtu janë të dukshme. Qeveria e Kosovës akoma nuk po ka mundësi të menaxhojë implementimin e kushtetutës në pjesën veriore të vendit, gjë që përbën edhe sfidën më të madhe në drejtim të konsolidimit të shtetësisë përbrenda. Kjo, në anën tjetër, ngrit shumë pyetje më rëndësi. Pyetja në vijim mund të konsiderohet si nga më të rëndësishmet: Si duhet të sillen institucionet e Kosovës në raport me dimensionin e brendshëm të shtetësisë, në veçanti me pjesën veriore të vendit? Çfarë masash strategjike apo specifike – qofshin ato politike, ekonomike, ligjore apo tjera – duhet të ndërmerren në mënyrë që Qeveria të jetë në gjendje të realizojë integrimin e pjesës së mbetur të komunitetit serb në sistemin shoqëror dhe politik të Kosovës?

Sa i përket organizimit dhe përmbajtjes, ky raport prezanton dhe përshkruan përmbajtjen kryesore të asaj që është thënë nga panelistët në një konferencë akademike ndërkombëtare të organizuar nga RIDEA në mars 2012, duke përfshirë edhe hulumtime dhe diskutime tjera me rëndësi. Gjithashtu, ky raport përmban edhe një varg rekomandimesh në të dyja aspektet e konsolidimit të shtetësisë: të brendshëm dhe të jashtëm.

ii. OBJEKTIVAT E HULUMTIMIT

Objektiva hulumtuese kryesore e këtij raporti është identifikimi i disa nga shumë përgjigjet e mundshme lidhur me pyetjet e identifikuara paraprakisht. Në mënyrë që të arrihet kjo objektivë, raporti (sikurse edhe Konferenca me temë të njëjtë e organizuar muaj më parë nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit) do të adresojë këto çështje: (a) pjesa e parë synon të identifikojë përgjigjet lidhur me sfidat e konsolidimit të brendshëm të shtetësisë së Kosovës, në veçanti sa i përket rebusit në veriun e Kosovës; dhe (b) pjesa e dytë diskuton dhe kërkon përgjigje të mundshme për problemin e konsolidimit të shtetësisë së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar.

iii. STRUKTURA E RAPORTIT

Siç u tha më parë, ky raport do të bazohet, por nuk limitohet vetëm, në diskutimet dhe gjetjet e Konferencës së organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012. Përveç kësaj, raporti do të përdorë edhe materiale tjera, siç janë intervistat konfidenciale më përfaqësuesit e Qeverisë, misioneve ndërkombëtare e të organizatave joqeveritare, persona nga sfera akademike, sikurse edhe publikime tjera me rëndësi.

Sa i përket konferencës, ajo është organizuar në formën e dy paneleve të specializuara me persona nga sfera akademike dhe politike. Panelistët ishin studiues me renome dhe ekspertë me njohuri të veçanta lidhur me temat e diskutuara. Ajo çfarë bie në sy është karakteri multidiciplinar i dijeve dhe njohurive që karakterizon pjesëmarrësit në konferencë. Temat e përzgjedhura (të përshkruara më lart) u diskutuan nga një varg dimensionesh dhe perspektivash, si e drejta ndërkombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare, sociologjia, ekonomia, kultura, filozofia etj. Agjenda e konferencës, bashkë me panelistët dhe profilin e tyre institucional, është e bashkëngjitur në këtë raport në formë të shtojcës.

Përveç panelistëve, në konferencë ishin të pranishëm edhe mbi 40 pjesëmarrës tjerë të profileve dhe fushave të ndryshme, duke përfshirë zyrtarë të lartë qeveritarë, zyrtarë ndërkombëtarë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe studentë (të studimeve bazë dhe atyre pasdiplomike). Konferenca kishte mbulim të gjerë mediatik dhe për të u raportua në edicionet e lajmeve qendrore.

I. A PO AFROHET FUNDI I LOJËS NË VERIUN E KOSOVËS? ALTERNATIVAT DHE SKENARET PËR ZGJIDHJEN E REBUSIT NË VERIUN E KOSOVËS

I.1. Sfondi i rebusit në veri të Kosovës

Në kontekstin e këtij studimi, është me rëndësi të theksohet që çështja e pakicave kombëtare, të cilat e gjejnë veten të ‘bllokuara’ apo ‘kurthuara’ në shtete pjesë e të cilave nuk dëshirojnë të jenë, është një çështje e njohur në historinë moderne të Evropës Qendrore dhe Lindore, Ballkanit e edhe më gjerë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Qëkur procesi i formimit të shteteve të reja sovraane në rajon filloi para rreth një shekulli, në fund të Luftës së Parë Botërore, bashkësitë etnike dhe kombëtare që u gjendën si pakica në shtete të cilat ato konsideronin se u përkisnin kombeve tjera, kanë qenë çështje dhe problem i përhershëm në politikën e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe Ballkanit¹. Prandaj, në perspektivë historike, çështja e serbëve të Kosovës (në veçanti serbëve në veri të Kosovës) nuk është diçka e re, por shembulli më i fundit i një çështje të vjetër dhe shumë të njohur.

Në këtë mënyrë, kjo pjesë e këtij studimi kërkon që të adresojë një qëllim sa delikat, po aq fundamental dhe të arritshëm, atë të përmirësimit dhe avancimit të raportit në mes të komunitetit serb në veriun e Kosovës dhe Qeverisë qendrore. Në thelb, sfida e integritit të pakicës serbe në Kosovë, si dhe pakicës serbe në veri të Kosovës në veçanti, daton që nga periudha e pasluftës (1999). Ky studim synon që të nxisë ndjenjën dhe realitetin e integritit më të madh të këtij komuniteti në sistemin institucional të Kosovës. Për më shumë, problemi i parashtruar është i lidhur ngushtë me trashëgiminë nga e kaluara. Në fakt, pa ju referuar historisë, konteksti i veçantë është i tillë që pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe themelimit të institucioneve të pavarura, disa serbë ju bashkuan këtyre institucioneve, e disa jo; këta të fundit kryesisht serbë që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës.

¹ Bose, Sumantra, prezantim në konferencën e organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012 në Prishtinë.

Me fjalë të tjera, pjesa veriore e Kosovës mbetet e paintegruar në sistemin politik, ekonomik, shoqëror dhe juridik të Kosovës. Në anën tjetër, institucionet e Kosovës janë pajtuar të zbatojnë Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të të Dërguarit Special të OKB-së Marti Ahtisari (Martti Ahtisaari), i njohur si ‘Plani i Ahtisarit’, pjesë thelbësore e të cilit është themelimi i një numri të komunave të banuara nga pjesëtarë të komuniteteve joshumicë. Një numër i komunave të reja (me përjashtim të komunës së Mitrovicës së Veriut) janë themeluar formalisht në Kosovën qendrore dhe jugore, gjë që është konsideruar si histori suksesi nga pjesa më e madhe e bashkësisë ndërkombëtare.²

Në këtë kontekst, kjo pjesë e studimit synon që të hulumtojë dhe identifikojë shkaqet dhe faktorët më me rëndësi që kushtëzojnë situatën e tillë në veriun e Kosovës. Për më shumë, përveç ravijëzimit të problemit dhe faktorëve kushtëzues, qëllimi është që të identifikohen alternativat dhe skenarët e mundshëm që çojnë deri te zgjidhja e rebusit në veriun e Kosovës.

I.2. Mjetet e analizës

Sa i përket metodologjisë së përdorur në këtë studim, në një mënyrë ajo synon që të jetë holistike dhe gjithëpërfshirëse, në vend se përjashtuese. Korniza analitike e studimit të rebusit në veriun e Kosovës është kryesisht e bazuar, por jo limituar, në punën e sociologut amerikan Roxhers Brubejkër (Rogers Brubaker). Më konkretisht, ky raport mbështetet në konceptin e Brubejkërit të njohur si ‘lidhja trepalëshe’ (*triadic nexus*).³

Koncepti i Brubejkërit përdoret në kontekst të transformimit dhe rindërtimit të shteteve në Evropën Juglindore pas rënies së komunizmit. Sipas tij, tensionet nacionaliste në procesin e shtetndërtimit dhe rindërtimit të shtetit mund të analizohen duke përdorur një lidhje të vetme ndërvarësie (‘lidhja e trefishtë’) që mban së bashku tre nacionalizma të

² Shih Raportin e Progresit të KE-së për Kosovën të vitit 2011.

³ Brubaker, Rogers (1996). National minorities, nationalizing states, and external national homelands in the neë Europe. Në: *Nationalism Reframed: Nationhood and the National Question in the New Europe*. Nju Jork: Cambridge University Press.

ndryshëm – nacionalizmin ‘nacionalizues’, nacionalizmin e ‘vendit amë’ dhe nacionalizmin ‘e pakicës’. Me fjalë të tjera, Brubejkëri ofron një kornizë të një raporti trepalësh në mes të një shteti të ri kombëtarizues, pakicës apo pakicave kombëtare, dhe shtetit kombëtar të jashtëm (zakonisht një ‘shtet amë’ në fqinjësi) të pakicës apo pakicave kombëtare.

Duke u bazuar në teorinë e Brubejkërit, Dejvid Xh. Smith (David J. Smith) ka propozuar një ‘lidhje të katërfishtë’ (‘quadratic nexus’) si kornizë analitike në studimin e procesit të shtetndërtimit, që ndërlidh shtetet kombëtarizuese, pakicat kombëtare dhe shtetet kombëtare të jashtme me institucionet e një rrjeti gjithnjë në rritje të organizatave ndërkombëtare.⁴ Kjo pasqyron rolin në rritje të aktorëve ndërkombëtarë në rajon si dhe tensionet dhe konfliktet në mes të aktorëve të ndryshëm. Ngjashëm, në rastin e Kosovës, dhe në këtë moment në veriun e Kosovës, është e domosdoshme të merret parasysh edhe një faktor i katërt – bashkësia ndërkombëtare apo aktorët ndërkombëtarë të përfshirë në rastin në fjalë.⁵ Me fjalë të tjera, ne duhet të marrim parasysh një shumësi pozicionesh dhe qëndrimesh të aktorëve të tillë si SHBA, BE, shtetet anëtare të BE-së, si dhe shtete si Rusia, Kina, India, Indonezia etj.

Rrjedhimisht, rebusi në veriun e Kosovës duhet parë në kontekst të këtij raporti katërpalësh në mes të Kosovës, serbëve në Kosovë (veçanërisht atyre në veri të vendit), Serbisë, si dhe bashkësisë (së përçarë) ndërkombëtare.

Bazuar në këtë kornizë analitike ne mund të skicojmë skenarët e mundshëm për zgjidhjen e rebusit në veriun e Kosovës dhe në këtë mënyrë të nxirren rekomandime të ndryshme për të gjitha palët e interesuara dhe të përfshira në këtë rebus.

⁴ Smith, David J. (2002) “Framing the National Question in Central and Eastern Europe: A Quadratic Nexus?” *The Global Review of Ethnopolitics* 2.1: 3-16.

⁵ Bose, Sumantra, prezantim në konferencën e organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012 në Prishtinë.

I.3. Skenarët e mundshëm për zgjidhjen e rebusit në veri të Kosovës

Në parim, ka të paktën pesë mënyra ose skenarë për zgjidhjen e problemit në veri të Kosovës.

Skenari *i parë* është që kjo pjesë e vendit të ri-integrohet përmes përdorimit të forcës, ngjashëm me aksionin e Qeverisë së Kroacisë kundër Republikës Serbe të Krajines (RSK) më 1995 apo atë të Qeverisë së Shri Lankës kundër rebelëve Tamil në veri të atij vendi më 2009. Kjo nuk është zgjidhje e mundshme në kontekstin e tanishëm gjeopolitik dhe rajonal të Kosovës. Mirëpo, nëse problemi vazhdon edhe në periudhën afatmesme, ky skenar nuk mund të anashkalohet në tërësi, meqë kjo çështje është e lidhur drejtpërdrejt me dilemën e sigurisë – të bëhet apo zhbëhet Kosova.

Skenari *i dytë* i mundshëm është ndarja e asaj pjese të Kosovës dhe bashkimi i saj me Serbinë në mënyrë të ngjashme me krijimin e Irlandës së Veriut nga gjashtë rajonet e Irlandës në fillim të viteve 1920 si pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, derisa 26 rajonet tjera fillimisht formuan Shtetin e Lirë Irlandez e më vonë Republikën e Irlandës. Ky skenar nuk është lehtë i realizueshëm për shkak të shumë vështirësive dhe komplikimeve. Një skenar i tillë kërkon arritjen e konsensusit të pjesshëm apo të përgjithshëm në shtetin e Kosovës dhe të Serbisë, dhe po ashtu nuk adreson çështjen e serbëve që jetojnë në pjesën qendrore dhe jugore të Kosovës. Për më shumë, kjo zgjidhje do të ishte e papranueshme për shumicën e popullatës në Kosovë. Gjithsesi, në rast se ndodh një skenar i tillë, do të kishte një efekt zinxhiror (domino) në rajon (p.sh., shqiptarët në Luginën e Preshevës, në Maqedoni, në Mal të Zi, pastaj serbët në Republika Srpska, në Mal të Zi etj.) Me fjalë të tjera, një zgjidhje e tillë do të hapte kutinë e Pandorës dhe shumica në bashkësinë ndërkombëtare kundërshton këtë skenar. Kësisoj, ky është një skenar pothuajse i perealizueshëm.

Skenari *i tretë* është që t'i jepet veriut të Kosovës autonomi e gjerë politike, e ngjashme me atë të Republika Srpska-s në Bosnjë dhe Hercegovinë apo atë të 'shtetit konstitutiv' vetëqeverisës turko-qipriot si pjesë e shtetit nominalisht të bashkuar 'Republika e Qipros së Bashkuar', propozuar nga OKB në vitin 2004. Kjo zgjidhje është e perealizuar në

kontekstin e tanishëm Kosovar, ngaqë është shumë e mundur që të mos pranohet nga klasa politike në vend dhe popullata shumicë shqiptare në Kosovë. Ngjashëm, kjo zgjidhje do të ishte e papranueshme edhe për një pjesë të popullit serb që jeton në rajonet e tjera të Kosovës. Po ashtu, kjo nuk garanton që Serbia do të njihte sovranitetin e Kosovës në këmbim. Për më shumë, kjo do të ndante Kosovën përbrenda (në mes serbëve në veri dhe shqiptarëve e komuniteteve tjera në pjesën tjetër të territorit) dhe do thellonte ndarjen e do krijonte status asimetrik për serbët në veri dhe ata në jug të vendit. Në fund të fundit, kjo zgjidhje (autonomi territoriale për veriuin e Kosovës) do të ishte një hap përpara në drejtim të krijimit të bazës për shkëputjen e kësaj pjese të territorit të Kosovës. Gjithashtu kjo do të mund të shkaktoje efekt zinxhiror, si në rastin e shqiptarëve në Luginën e Preshevës, shqiptarëve në Maqedoni etj. Rrjedhimisht, duke patur parasysh faktet e lartpërmendura, mund të thuhet që kjo zgjidhje nuk është e mundur dhe po ashtu nuk është në pajtim me vlerat dhe parimet Evropiane.

Skenari *i katërt* është si në rastin e Bërçkos në Bosnjë dhe Hercegovinë. Në këtë rast, bashkësia ndërkombëtare ka krijuar një ‘zonë inkubacioni’ të veçantë në mënyrë që të promovohen lidhjet multietnike dhe vlerat e parimet demokratike. Gjithsesi, kjo strategji “e ka integruar Bërçkon jo shumë suksesshëm në shtetin e Bosnjës dhe Hercegovinës, pjesërisht për shkak të raportit të saj të veçantë me shtetin, duke qenë në ‘bashkëpronësi’ (kondominium) të të dy ‘njësive’ të Bosnjës, Federatës boshnjako-kroate dhe Republika Srpska-s”.⁶ Duke marrë parasysh faktin që deri në njëfarë mase veriu i Kosovës është në ‘bashkëpronësi’ (kondominium) edhe të Kosovës edhe të Serbisë, edhe kjo strategji do të ishte jofunksionale dhe si pasojë do të prodhonte një integrim të dështuar të veriut të Kosovës me pjesën tjetër të Kosovës.

Skenari *i fundit*, për nga radha por jo edhe rëndësia, do të ishte implementimi i plotë i Planit të Ahtisarit në veriuin e Kosovës në mënyrë paqësore. E shikuar nga perspektiva e raportit katërpalësh të diskutuar më herët, kjo zgjidhje do të kënaqte Qeverinë e Kosovës,

⁶ Binnendijk, H. et al (2006) ‘Solutions for Northern Kosovo: Lessons Learned in Mostar, Eastern Slavonia, and Brčko’, *Center for Technology and National Security Policy*.
<http://www.ndu.edu/CTNSP/docUploaded/DTP%2034%20Mitrovica.pdf>

serbët në jug të Kosovës dhe shumicën në bashkësinë ndërkombëtare. Mirëpo, tash për tash kjo zgjidhje nuk është e pranueshme për Serbinë, serbët në veri të Kosovës dhe disa shtete në bashkësinë ndërkombëtare (p.sh Rusinë). Siç u tha edhe më herët, nuk ka një zgjidhje për rebusin në veri të Kosovës që do t'i kënaqte që të gjitha palët në 'raportin katërpalësh'. Mirëpo, sipas këtij studimi, zgjidhja më e mirë dhe më lehtë e realizueshme për problemin në veri të Kosovës është implementimi i plotë i Planit të Ahtisarit. Në thelb, Plani i Ahtisarit është skenari i vetëm që është në përputhje me vlerat Evropiane dhe konceptin e patriotizmit kushtetues⁷, që është edhe fundament i vetë ngrehinës moderne politike Evropiane. Për shembull, disa nga dimensionet e shtetit të Kosovës që ndërlidhen me konceptin e patriotizmit kushtetues janë: a) kushtetuta; b) sistemi politik; dhe c) simbolet shtetërore.

Sa i përket Kushtetutës së Kosovës, teksti është në themel i pavërejtje, me referime të vazhdueshme në karakterin multietnik të Kosovës dhe në barazinë e të gjithë qytetarëve. Sistemi politik, në anën tjetër, ruan dhe promovon këto vlera nëpërmjet aplikimit të parimit të vendeve të rezervuara për komunitetet pakicë në sistemin zgjedhor dhe në parlament. Ky është një shembull pozitiv i shprehjes së përkushtimit të shtetit për të përfaqësuar interesat e të gjitha grupeve etnike. Simbolet e shtetit janë po ashtu reflektim i idesë se secili komunitet ka nevojë për simbole që e përfaqësojnë atë, dhe që individët të mund të identifikohen me to. Flamuri dhe himni i Kosovës janë në këtë vijë dhe duken të

⁷ Patriotizmi Kushtetues së pari është formuluar në vitin 1979 nga Dolf Shternberger (Dolf Sternberger), një politikolog gjerman, dhe fillimisht është konceptuar në raport me kontekstin e veçantë gjerman. Në dekadën në vijim, Jurgen Habermasi (Jürgen Habermas) adoptoi dhe e popullarizoi këtë koncept. Derisa Shternbergeri ishte i preokupuar vetëm me Gjermaninë, Habermasi ka theksuar që ideja e Patriotizmit Kushtetues është baza më e përshtatshme për identitetet kombëtar në çfarëdo shteti, si dhe për një identitet të ardhshëm Evropian. Ai thotë që nëse identiteti kombëtar është i bazuar në veti të veçanta kulturore (si gjuha, feja apo tradita e veçantë etnike), atëherë kjo do të përjashtojë ata individë apo grupe në shtet që nuk i ndajnë këto veti apo nuk identifikohen me to, duke krijuar probleme për kohezionin shoqëror dhe integrimin. Ky konstatim është veçanërisht relevant kur kihet parasysh fakti që shumica e shteteve në botë janë në të vërtetë shumëetnike. Në këtë kontekst, qëllimi i patriotizmit kushtetues është që të krijojë një komb të qytetarëve, besnikëria politike dhe identifikimi kolektiv i të cilëve është me bashkësinë shumëetnike, politike dhe shtetin që garanton liri dhe trajtim të barabartë për të gjithë. Rodriguez, Mateo, prezantim në konferencën e organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012 në Prishtinë.

jenë zgjedhur me shumë kujdes që mundësisht të jenë të pranuar për pjesëtarët e të gjitha komuniteteve.⁸

I.4. Përfundime

Mënyra se si rebusi në veriun e Kosovës evoluon në muajt dhe vitet në vijim do të varet para së gjithash nga natyra e evoluimit të raportit katërpalësh në mes Kosovës, Serbisë, serbëve të Kosovës (para së gjithash atyre në veri të vendit) dhe bashkësisë ndërkombëtare. Gjithsesi, të gjitha faktet, si dhe përmbajtja e Planit të Ahtisarit dhe të qenurit e tij në pajtim me vlerat dhe parimet Evropiane, e bëjnë këtë skenar si zgjidhjen më reale për veriun e Kosovës. Prandaj, ky studim përkrah implementimin e plotë të Planit të Ahtisarit në tërë territorin e Kosovës si të vetmen zgjidhje të mundshme për problemin e veriut të Kosovës. Në seksionin në vijim paraqiten disa rekomandime lidhur me lëvizjen përpara në drejtim të implementimit të Planit të Ahtisarit në veriun e Kosovës.

I.5. Rekomandime

Rekomandimet e këtij studimi janë të ndara në tri grupe: a) rekomandime për Qeverinë e Kosovës; b) për serbët në Kosovë (veçanërisht ata në veri); dhe c) për bashkësinë ndërkombëtare. Konfliktet etnike brenda një shteti, dhe në këtë rast rebusi në veri të Kosovës, zgjidhen ose përmes forcës dhe fitores ushtarake ose me një zgjidhje përmes bisedimeve. Mirëpo, siç u cek edhe më lart, forca brutale nuk është mjet për zgjidhjen e problemit në veri të Kosovës. Kësisoj, rekomandimi i parë i përgjithshëm për të gjitha palët e përfshira në zgjidhjen e rebusit është që të përkushtohen në dialog.

a) Rekomandimet për Qeverinë/Institucionet e Kosovës:

- ***Së pari***, para se të hyhet në çfarëdo dialogu, qoftë me Serbinë (për normalizim të raporteve), apo me palët e interesuara dhe përfshira në veri të Kosovës lidhur me

⁸ Po aty.

problemin në atë pjesë të vendit, Qeveria e Kosovës duhet të kërkojë unitet politik në Prishtinë ndërmjet shumicës së partive parlamentare. Rezoluta e fundit e miratuar në Kuvendin e Kosovës mund të shërbej si një shembull/model i mirë në përpilimin e një platforme konsensuale dhe në vija të përgjithshme brenda Kuvendit të Kosovës. Ngjashëm deputetët e Kuvendit (dhe sidomos deputetët dhe profesionistët në mesin e partive opozitare) nëpërmjet komisioneve parlamentare do të duhej të asistonin dhe merrnin pjesë në ekipe të ndryshme teknike gjatë gjithë procesit të dialogut. Kjo gjithashtu nënkupton që të gjithë aktorët relevantë politik në Kosovë janë të përfshirë në këtë proces.

- **Së dyti**, pas përcaktimit të hapit të parë, Kosova duhet të kërkojë në mënyrë këmbëngulëse nga bashkësia ndërkombëtare që të sigurojë dhe të mbikëqyrë tërheqjen e menjëhershme të zyrtarëve të sigurisë, mbrojtjes, drejtësisë, dhe shërbimit sekret të Serbisë nga veriu i Kosovës dhe pjesët tjera të vendit. Në skenarin më të mirë, kjo do të duhej të ndodhte para çfarëdo ri-nisjeje apo vazhdimi të dialogut me serbët lokalë apo me Serbinë. Arsyeja për këtë është e lidhur me faktin që një veprim i tillë do të krijonte kushte normale për dialog – përndryshe çdo dialog do të mund të ishte i pakuptimtë. Kjo gjithashtu është në pajtim me Rezolutën 1244/99 të OKB-së, që është dokument i tejcituar nga Qeveria dhe institucionet e Serbisë. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës duhet të përkrah dhe të forcojë edhe më shumë Zyrën Administrative për Mitrovicën e Veriut;
- **Së treti**, pas kompletimit të dy hapave të parë, Qeveria e Kosovës, me ndihmën dhe përkrahjen e bashkësisë ndërkombëtare, duhet të përkushtohet për një dialog gjithëpërfshirës me të gjitha palët në veri të vendit. Ky dialog duhet të adresojë nevojat dhe shqetësimet e qytetarëve në atë pjesë të vendit. Kura më e mirë për këtë është vetëdijesimi i serbëve lokalë për përmbajtjen dhe përparësitë e Planit të Ahtisarit, gjë që duhet të shkojë dorë për dorë me një plan konkret socio-ekonomik për zhvillimin e asaj pjese të territorit të Kosovës. Qeveria e Kosovës

me ndihmën e donatorëve ndërkombëtar do të mund të themelonte një fond të veçantë zhvillimor për këtë pjesë të Kosovës. Për më shumë, ky dialog duhet të adresojë problemin dhe arrijë një marrëveshje lidhur me të drejtën e pjesëtarëve të të gjitha komuniteteve që të kthehen në pronat e tyre në veri të Mitrovicës dhe për të drejtën e serbëve nga veriu i Kosovës që të mund të kthehen në pronat e tyre gjithandej Kosovës. Ky proces duhet që të çojë deri te zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike në të gjitha komunat në veri të Kosovës, duke përfshirë edhe komunën e re të Mitrovicës së Veriut. Në fund, Qeveria e Kosovës duhet që të adresojë dhe të zgjidh nëpërmjet dialogut çështjen e integritit të sektorit gjyqësor, policor dhe arsimor në veri të Kosovës me pjesën tjetër të vendit në përputhje me Planin e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës. Krejt në fund, kjo duhet të çojë drejt arritjes së një marrëveshje gjithëpërfshirëse në mes të Qeverisë së Kosovës dhe palëve të interesuara dhe përfshira në veriun e Kosovës në pajtim me Planin e Ahtisarit dhe Kushtetutën e Kosovës;

- Në anën tjetër, rreth dialogut me Serbinë lidhur me normalizimin e raporteve dypalëshe, Qeveria e Kosovës duhet të insistoj në kushtet nga rekomandimi i dytë të përshkruara më sipër, përpara rinisjes së këtij dialogu. Në këtë pikë, Kosova duhet të insistoj gjithashtu në implementimin përmbajtësor në praktikë të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit (IBM) dhe të të gjitha marrëveshjeve të tjera të arritura në dialogun teknik në mes Serbisë dhe Kosovës;
- Çështjet më me rëndësi që Kosova duhet të kërkojë t'i adresojë në dialogun për normalizimin e raporteve me Serbinë janë: demarkacioni i kufirit, personat e pagjetur, fondi pensional kosovar i plaçkitur nga Serbia në vitin 1999, dëmet e luftës, suksesioni dhe çështje tjera të ndërlidhura. Qeveria e Kosovës nuk duhet të përfshihet në diskutime për ndonjë temë tjetër që do mundësonte hapjen e çështjes së statusit të Kosovës, apo ndonjë temë tjetër që bie ndesh me Kushtetutën.

b) Rekomandimet për serbët në Kosovë (veçanërisht ata që jetojnë në veri të Kosovës):

- Gjendja e tanishme në veri të Kosovës në rend të parë nuk është në interesin e njerëzve që jetojnë në atë pjesë të vendit. Një jetë normale, e qetë dhe prosperuese është në interesin e të gjithëve që jetojnë në atë pjesë të Kosovës. Mënyra e vetme për të arritur këtë është përkushtimi i sinqertë në një dialog qytetar me Qeverinë e Kosovës dhe aktorët relevantë ndërkombëtarë. Themelimi i shpejtë i institucioneve dhe vendosja e rendit dhe ligjit në veri të Kosovës, zgjedhjet e lira, të drejta dhe demokratike dhe zhvillimi ekonomik janë në rend të parë në interesin e shumicës së qytetarëve (pavarësisht përkatësisë etnike) në veri të Kosovës;
- Procesi i decentralizimit në pjesën tjetër të Kosovës është përmbyllur me sukses. Është fakt mirë i njohur që ky proces ka ndryshuar në mënyrë pozitive jetën e shumë njerëzve që jetojnë në komunat me shumicë serbe të krijuara rishtazi. Kjo duhet të shërbejë si një shembull dhe model për qytetarët e veriut të Kosovës, në mënyrë që ata të përkrahin themelimin e komunës së re në Mitrovicën e Veriut;
- Zyra administrative e themeluar sëfundmi është një hap i duhur në drejtim të vendosjes së kontakteve dhe komunikimit në mes të serbëve lokalë dhe Qeverisë së Kosovës. Serbët lokalë duhet të përdorin shërbimet e kësaj zyre në mënyrë që të rritet përkrahja për procesin e decentralizimit në veri të Kosovës. Në këtë kontekst, qytetarët në veri të Kosovës duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin që Plani i Ahtisarit ofron të drejta të veçanta për komunat me shumicë serbe në administrimin e çështjeve të tyre. Në thelb, ky plan është “i ngjashëm me strukturat qeverisëse në Belgjikë, Irlandë të Veriut/Mbretëri e Bashkuar dhe Bosnjë, transferon kompetenca thelbësore te njësitë lokale të qeverisjes dhe madje ju lejon këtyre njësitë kompetenca lidhur me bashkëpunimin ndërkufitar me

shtete tjera në fusha dhe sfera të caktuara”.⁹ Rasti i Belgjikës mund të përmendet sa për ilustrim. Për shembull, “komunitetet gjuhësore në Belgjikë rregullojnë çështjet arsimore në bazë të parimit funksional, që do të thotë se komuniteti frankofon dhe flaman qeverisin shkolla të veçanta brenda territorit të Brukselit”.¹⁰ Për më shumë, që të dyja komunitetet janë të lejuara që të nënshkruajnë traktate për politikën arsimore me shtete të tjera.¹¹ Plani i Ahtisarit garanton të drejta të njëjta për komunat me shumicë serbe në përgjithësi dhe atë në Mitrovicën e Veriut në veçanti. Serbët nga veriu i Kosovës duhet të kërkojnë mundësinë që të integrohen në institucionet qendrore të Kosovës dhe të përfitojnë nga 20 vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës. Duhet theksuar që edhe në këtë aspekt Kosova është mjaft e avancuar. Për shembull, Kroacia dhe Sllovenia ndajnë 8 (nga 151) respektivisht 2 (nga 90)¹² ulëse për pakicat, që janë shumë më pak se në Kosovë. Prandaj, kjo ilustron më së miri faktin se Plani i Ahtisarit është shumë gjeneroz në raport me serbët në Kosovë dhe për këtë arsye këta të fundit duhet ta shfrytëzojnë këtë mundësi që ju ofrohet.

c) Rekomandime për bashkësinë ndërkombëtare:

- Bashkësia ndërkombëtare (në veçanti Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) duhet të ndihmojnë dhe lehtësojnë dialogun në mes të Qeverisë së Kosovës dhe serbëve në veri të Kosovës dhe dialogun paralel për normalizimin e raporteve ndërmjet autoriteteve të Prishtinës dhe Beogradit;
- Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të kërkojnë dhe pastaj të mbikëqyrin tërheqjen e menjëhershme të aparatit serb të sigurisë nga Kosova, duke përfshirë edhe zyrtarët e shërbimit sekret. Në fakt, në mënyrë që të arrihet ky qëllim kërkohet vullnet i mirë nga ana e Qeverisë së Serbisë. BE posedon mekanizmin e fuqishëm të ‘shkopit dhe karrotës’ dhe ajo duhet që ta

⁹ Stroschein, S (2008) ‘Making or Breaking Kosovo: Applications of Dispersed State Control’, *Perspectives on Politics*. Vol. 6/No. 4, p. 655.

¹⁰ Po aty, 656.

¹¹ Po aty.

¹² Kroacia ka vende të rezervuara për Hungarezët, Italianët, Çekët, Sllovakët, Ruthenianët, Ukrainasit, Gjermanët dhe Austriakët. Ndërsa Sllovenia për Hungarezët dhe Italianët.

përdorë atë në mënyrë që të drejtojë sjelljen e Qeverisë së Serbisë në veri të Kosovës. BE duhet patjetër që të përdorë këtë mundësi në mënyrë që të mos lejoj edhe një Qipro tjetër me kufi të padefinuar brenda gjirit të saj;

- Për zgjidhjen e rebusit në veri të Kosovës, BE dhe SHBA duhet që të promovojnë dhe garantojnë implementimin e Planit të Ahtisarit. Ato duhet të bëjnë të qartë që fundja ky plan është rezultat kompromisi në mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, e jo pozicion fillestar i Kosovës. Çdo zgjidhje tjetër që do të mund të çonte kah autonomia territoriale si në rastin e Katalonisë në Spanjë, Tirolit Jugor në Itali, Krimesë në Ukrainë apo Kebekut në Kanada, thjesht krijon bazat për një ‘minishtet’ brenda Kosovës. Kjo do ta bënte shtetin e Kosovës jofunksional dhe do të hedhte bazat për shkëputjen përfundimtare të kësaj pjese nga territori i Kosovës. Dhe, në fakt, “përderisa Plani [i Ahtisarit] zyrtarisht shmang ravijëzimin e autonomisë territoriale, një koncentrim i komuniteteve serbe në veri, kombinuar me strukturat komunale, *de facto* prodhon një shkallë të gjerë të autonomisë territoriale për këtë rajon.¹³ Prandaj, legalizimi i autonomisë territoriale të veriut të Kosovës (që shkon përtej Planit të Ahtisarit) do të ishte vetëm hapi i parë drejt një konflikti të ri në rajon dhe bashkësia ndërkombëtare nuk duhet ta bëjë këtë gabim. Në të vërtetë, kjo do të mund të zgjidhte problemin në periudhë afatshkurtër, por pavarësisht kësaj, integrimi etnik do të mbetet pothuajse i paarritshëm dhe kjo e bën këtë zgjidhje të papajtueshme me vlerat dhe parimet Evropiane. Për këtë arsye, ky studim i rekomandon bashkësisë ndërkombëtare që të implementojë plotësisht Planin e Ahtisarit si zgjidhjen e vetme dhe më të mirë për problemin në veri të Kosovës.

¹³ Stroschein, S (2008) ‘Making or Breaking Kosovo’, 662.

II. NJOHJA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS: PERSPEKTIVA ‘INVENTARIZUESE’ DHE E ‘SHIKIMIT PËRPARA’

Sfondi i paevitueshëm i këtij seksioni të studimit pa dyshim formohet nga realitetet që rrethojnë vendin dhe statusin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Një përshkrim më i detajshëm i këtyre realiteteve do të ishte si në vijim:

Deri më sot, Republika e Kosovës është njohur nga më shumë se 90 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara, përfshirë edhe 22 nga 27 shtetet anëtare të BE-së, 34 nga 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, 2/3 e shteteve anëtare të OSBE-së, gjysma e shteteve anëtare të Ligës Arabe, dhe për afërsisht gjysma e shteteve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik. Kosova po ashtu është anëtarësuar në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Fotografia e plotë përmban një tjetër pjesë, akoma të pakompletuar, të aspiratës së Kosovës për t’u bërë anëtar me të drejta të plota i bashkësisë ndërkombëtare. Sfidat kryesore që mbesin i referohen faktit që (a) Kosova akoma nuk është anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe një numri organizatash tjera relevante Evropiane dhe ndërkombëtare, si Këshilli i Evropës dhe OSBE-ja, dhe (b) akoma nuk është njohur nga pesë shtete anëtare të BE-së (edhe pse pozicionet e këtyre shteteve, të paktën në disa aspekte, nuk janë të unifikuara).

Sfondi i mëtutjeshëm pashmangshëm është i formësuar nga procese dhe vendime tjera si opinioni këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) në lidhje me legalitetin e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të lehtësuar nga BE dhe të paraparë me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 64/298 dhe, mbase, në veçanti, marrëveshjen e arritur në mes të palëve për përfaqësimin dhe bashkëpunimin rajonal të 24 shkurtit 2012.

Ky sfond i shkurtër, por përmbajtësor, ngre një sërë pyetjesh që janë në gjendje të ndikojnë proceset vendimmarrëse të menjëhershme apo ato afatgjata për dhe rreth

Kosovës dhe, më gjerësisht, të një rëndësie thelbësore për të tjerët që shohin apo kërkojnë përfitime nga rezultatet e Kosovës për nevoja dhe qëllime të tyre.

Në mesin e shumë pyetjeve që janë të kushtëzuara nga konteksti i përshkruar janë: Si duhet të adresojnë institucionet e Kosovës çështjen e konsolidimit të mëtutjeshëm të shtetësisë së Kosovës ndërkombëtarisht, në kontekst të njohjeve dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare që aspiron? Çka mund dhe duhet të bëhet në mënyrë që Kosova të bëhet anëtar i barabartë dhe me të drejta të plota i bashkësisë ndërkombëtare? Çfarë problemesh mund të priten dhe cilat janë perspektivat për arritjen e qëllimeve të dëshiruara?

Seksionet në vazhdim të kësaj pjese të studimit ofrojnë një diskutim për këto pyetje.

II.1. Një vlerësim krahasues: Kosova dhe të tjerët

Metoda e parë themelore e këtij seksioni është të shikohen trendet nga e kaluara në vendimmarrje në mënyrë që të kuptohen dhe shpjegohen realitetet në Kosovë, dhe të kuptohen efektet e mirëfillta dhe implikimet e trendeve të tilla.

Duhet thënë që në fillim se Kosova nuk është shteti i vetëm që, të paktën për disa kohë, ka tërhequr njohje të pjesshme, edhe pse relativisht domethënëse. Periudha e pas Luftës së Dytë Botërore ofron fakte të mjaftueshme për ekzistimin e shteteve që kanë përjetuar shkallë të ndryshme të njohjes. Në aspektin doktrinar, tri kategori të tilla të shteteve janë identifikuar: Në kategorinë e parë janë shtetet që kanë arritur njohje të gjerë vetëm pas një periudhe të tejzgjatur të mosnjohjes. Në kategorinë e dytë janë rastet kur njësitë politike kanë marrë shumë pak njohje dhe kështu ju është mohuar shtetësia. Dhe së treti, kemi rastet ku njësitë politike që kanë aspiruar shtetësinë kanë marrë shumë pak apo aspak njohje.¹⁴ Raste të këtyre njësive që kanë marrë pak ose aspak njohje janë: Abkazia dhe Osetia Jugore në Gjeorgji (të cilat kanë marrë njohje nga gjashtë, respektivisht pesë

¹⁴ Caplan, Richard, prezantim në konferencën e organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012 në Prishtinë.

shtete të OKB-së); Biafra në Nigeri (e njohur vetëm nga pesë anëtarë të OKB-së); Republika Turke e Qipros Veriore (e njohur vetëm nga Turqia); Çeçenia në Rusi (e njohur vetëm nga Afganistani nën regjimin e Talibanëve); Katanga në Kongo (pa asnjë njohje); dhe Somalilandi në Somali (po ashtu pa asnjë njohje).

Rasti që megjithatë ka disa ngjashmëri me Kosovën konsiderohet të jetë Bangladeshi (më parë i njohur si Pakistani Lindor). Qoftë sa i përket përvojës nga e kaluara (shtypje apo agresion nga shteti pjesë e të cilit kanë qenë), qoftë sa i përket zhvillimeve të mëvonshme (p.sh. intervenimi i jashtëm ushtarak: nga NATO në rastin e Kosovës, dhe nga India në Bangladesh), këto dy vende kanë shumë ngjashmëri. Gjithashtu, ato nuk janë njohur plotësisht nga shtetet tjera pas shpalljes së pavarësisë së tyre, e as nga shtetet nga të cilat janë pavarësuar. Mirëpo, dallimi kryesor në mes të këtyre dy shteteve është që mosnjohja e Bangladeshit nga Pakistani ka zgjatur dy vjet (deri në shkurt 1974) periudhë kur Bangladeshi pranohet në OKB, derisa në rastin e Kosovës, edhe më shumë se katër vjet nga shpallja e pavarësisë, vendi nuk është njohur nga Serbia e as nuk është anëtarësuar në OKB.

Deri më tani janë prezantuar vetëm përvojat e entiteteve të ndryshme. Mirëpo, çështja se sa e rëndësishme ose jetike është njohja për shtetësinë, është pyetje krejt tjetër që do shtjellohet në seksionin në vijim.

II.2. Njohja: Vlera dhe Rëndësia që ka për Shtetësinë

Teoria e së drejtës ndërkombëtare njih dy pikëpamje dominuese lidhur me rëndësinë e njohjes ndërkombëtare në procesin e shtetndërtimit. Këto janë teoria deklarative dhe teoria konstitutive.

Teoria deklarative konsideron që njohja ka karakter deklarativ në raport me shtetësinë, pra është thjesht njohje e ekzistimit të shtetit. Në këtë pikëpamje, akti i njohjes nuk përbën krijim të shtetit. Konventa e Montevideos e vitit 1933 për të Drejtat dhe Obligimet e Shteteve përkrah pikëpamjet e kësaj teorie. Neni 3 i Konventës thotë:

Ekzistenca politike e Shtetit është e pavarur nga njohja nga Shtetet tjera. Edhe para njohjes, Shteti ka të drejtë të mbrojë integritetin dhe pavarësinë e tij, të garantojë ruajtjen dhe prosperitetin e tij, dhe rrjedhimisht të organizojë vetën siç ai e sheh të arsyeshme, të nxjerrë ligje lidhur me interesat e tij, administroj shërbimet e veta dhe të definojë juridiksionin dhe kompetencat e gjykatave të veta.

Ky pozicion i përkrahur nga Konventa e Montevideos gjithashtu është përkrahur edhe nga opinione të organizatave dhe mekanizmave të ndryshëm. Për shembull, Komisioni i Arbitrazhit i Këshillit Evropian për ish-Jugosllavinë, i njohur si ‘Komisioni i Badinterit’, konsideron që “efektet e njohjes nga shtetet tjera janë krejtësisht deklarative.”

Pikëpamje të kundërta janë të mbledhura rreth asaj që njihet si teoria konstituive. Pikëpamjet e kësaj teorie janë të bazuara në premisën që njohja nuk është vetëm deklarative, por posedon edhe rol të rëndësishëm politik për ekzistencën e shtetësisë. Trendet nga e kaluara kanë ofruar shembuj kur shtetet kanë funksionuar si të tilla dhe kanë gëzuar të drejta të asocuara me shtetësinë edhe në mungesë të njohjes formale apo njohjes së plotë (p.sh. Izraeli në raport me mosnjohjen nga shtetet arabe apo Maqedonia në vitet 1991 deri 1993).

Pa marrë parasysh konsideratat teorike, askush nuk mund të mohojë rolin dhe kontributin e njohjes nga bashkësia ndërkombëtare e shteteve të reja të pavarura, jo vetëm për qëllime të integritimit në bashkësinë e shteteve të botës (p.sh OKB), por edhe për qëllime të konsolidimit të brendshëm.

Siç u tha edhe më lart, Kosova është njohur nga më pak, apo përafërsisht, gjysma e shteteve anëtare të OKB-së, dhe sa i përket anëtarësimit në organizata ndërkombëtare, ajo është anëtare e shumë pak organizatave globale. Përveç Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, Republika e Kosovës nuk ka mundur t’i bashkohet ndonjë organizate tjetër të përmasave të njëjta, edhe pse është në pozitë t’i bashkohet disa organizatave të mëdha me bazë në Evropë, si Këshilli i Evropës (KiE) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Edhe nëse anëtarësohet, gjasat janë që

anëtarësimi në KiE nuk do të ndodhë në një të ardhme të afërt, gjë që nuk vlen edhe për anëtarësimin në BERZH.

II.3. Përfundime

Në kundërshtim me atë që është pritur, apo duket të jetë pritur, ndikimi i mendimit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, pavarësisht tonit afirmativ për Kosovën, nuk ka ndryshuar pasqyrën e njohjeve dhe statusin ndërkombëtar të Kosovës në një mënyrë radikale apo rrënjësore. Andaj, me të drejtë mund të pyetet: Çka do të ndodhte sikur vendimi të ishte ndryshe (në kuptimin negativ)?

Nga vrojtimet paraprake mund të thuhet që, edhe pse kritike në sferën e marrëdhënieve ndërkombëtare, çështja nëse shpallja e pavarësisë është apo ka qenë në pajtim (apo në kundërshtim) me të drejtën ndërkombëtare, mund të mos ketë vlerë të plotë determinuese. Në këtë kuptim, e drejta ndërkombëtare duket të jetë vetëm një copëz e një shumësie faktorësh që formësojnë realitetin në arenën ndërkombëtare. Prandaj, ndikimi i mendimit të GJND-së në 21 njohjet që kanë ndodhur qyshkur, nuk mund të matet lehtë në mënyrë objektive. Ndjenja e përgjithshme është se mendimi i GJND-së ka ofruar një përbërës shumë kredibil dhe autoritativ për argumentin në favor të njohjes, në veçanti sa i përket atyre shteteve që kanë formësuar (apo kanë thënë se kanë formësuar) qëndrimet dhe mendimet e tyre bazuar në karakterin legal apo jolegal të aktit të shpalljes së pavarësisë.

Përtej sferës së konsideratave të pastërta juridike ndërkombëtare, ekziston një përshtypje e përgjithshme që nocioni i *effectivité* (efektivitetit) të një njësie politike është shtylla mbajtëse e shtetësisë. Siç u tha edhe më lart në raport, edhe dimensionin e brendshëm edhe ai i jashtëm i konsolidimit të shtetësisë janë më rëndësi.

Nëse shikojmë prapa dhe vlerësojmë çfarë është arritur në Kosovë deri më tani, lirisht mund të përfundohet që edhe efektiviteti (*effectivité*) i brendshëm edhe ai i jashtëm janë

larg të qenurit të parëndësishëm.¹⁵ Prandaj, krijimi i një game strukturash të brendshme politike dhe institucionale dhe funksionalizimi i tyre, sikurse dhe njohja nga më shumë se 90 shtete anëtare të OKB-së, janë larg nga të qenurit arritje pa vlerë. Në mungesë të anëtarësimit në OKB (konsolidimi i jashtëm) dhe ushtrimit të plotë të autoritetit në pjesë të ndryshme të territorit, veçanërisht në veri, (konsolidimi i brendshëm), situata është e tillë që nuk kënaq aspiratat e një anëtari me të drejta të plota të komunitetit botëror të shteteve.

Ky sfond prandaj kërkon përpjekje, strategji dhe masa që avancojnë qëllimet e synuara. Meqë verdikti lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës tashmë është dhënë dhe ky verdikt është dhënë nga organi më i lartë gjyqësor në botë, duhet që fokusi të zhvendoset në çështjet që kanë të bëjnë me arritjen dhe ruajtjen e efektivitetit (*effectivité*) të brendshëm dhe të jashtëm. Derisa nënseksioni në vazhdim ofron disa rekomandime më të detajuara, pashmangshmërisht duhet të thuhet që ka dy rrugë të pazëvendësueshme për konsolidimin e mëtutjeshëm të shtetësisë së Kosovës: (1) konsolidimi i kredencialeve demokratike të Kosovës; dhe (2) konsolidimi i gjendjes ekonomike. Prandaj, përmirësimi dhe perfeksionimi i vlerave dhe virtyteve ekzistuese demokratike dhe rivitalizimi i ekonomisë mbeten vitale jo vetëm për konsolidimin e efektivitetit të brendshëm, por edhe për forcimin e dimensionit të jashtëm të shtetësisë së Kosovës.

II.4. Opsione Politike dhe Rekomandime

Gjendja në Kosovë, edhe pse me shkallë të vërejtshme të arritjeve, ka nevojë për më shumë përparim dhe konsolidim në mënyrë që të arrihet aspirata për një shtet të mirëfilltë, anëtar me të drejta të plota në bashkësinë ndërkombëtare të shteteve. Si të arrihet kjo? Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës, apo si duhet që të adresojnë

¹⁵ D'Aspremont, Jean, prezantim në konferencën e organizuar nga RIDEA dhe Qendra për Studime Ndërkombëtare – Universiteti i Oksfordit në mars 2012 në Prishtinë.

çështjen e konsolidimit të mëtutjeshëm të shtetësisë së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar?

Këto janë disa pyetje kyçe për të cilat ofrohen opsionet politike dhe rekomandimet në vijim:

- Konsolidimi i brendshëm mbetet faktor kyç sa i përket imazhit dhe perceptimit të jashtëm pozitiv. Kosova duhet që të vazhdojë të avancojë edhe më tutje proceset e zhvillimit demokratik dhe ekonomik, duke përfshirë edhe një nga fushat më me rëndësi, atë të sundimit të rendit dhe ligjit. Në këtë mënyrë, vendi jo vetëm që do të zhvillohet për vete, por do të minimizojë kritikën dhe skepticizmin e jashtëm lidhur me sjelljen e saj dhe qëndrueshmërinë, dhe do të bindte të tjerët për nevojën dhe meritat e një vendimi të mundshëm për njohje.
- Në mungesë të njohjes nga Serbia dhe pranimi në OKB, Kosova duhet të vazhdojë dhe të intensifikojë lobimin aktiv jashtë vendit. Në këtë kontekst, ajo duhet të vazhdojë të punojë në partneritetet të ngushtë më aleatët e saj kryesorë, që kanë apo mund të kenë ndikim në shumë vende dhe rajone të botës.
- Kosova duhet që të shfrytëzojë praninë e saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare në të cilat është anëtare për të forcuar shtetësinë dhe të vendosë e thellojë marrëdhëniet me shtetet që akoma nuk e kanë njohur atë.

SHTOJCA I

PROGRAMI I KONFERENCËS

16 mars 2012

Arritja e folësve/panelistëve

20:30 – 22:30

Darkë në restorantin Tiffany

17 mars 2012

9.00 Regjistrimi dhe kafe

9.30 Fjalë mirëseardhjeje

Kryesues i Konferencës: Dr. Labinot Greiçevci (RIDEA)

**9.45 Paneli i Parë: NJOHJA NDËRKOMBËTARE E KOSOVËS: PERSPEKTIVA
'INVENTARIZUESE' DHE E 'SHIKIMIT PËRPARA'**

Kryesues i panelit: Dr. Qerim Qerimi (RIDEA dhe Universiteti i Prishtinës)

Folësit:

Prof. Richard Caplan

Universiteti i Oksfordit

Dr. Ralph Wilde

Kolexhi Universitar Londër

Dr. Jean d'Aspremont

Universiteti i Amsterdemit

Dr. Othon Anastasakis

Universiteti i Oksfordit

Elizabeth Pond

Universiteti Xhon Hopkins

11.15-11.30 Pauzë për kafe

11.30.-12.30 Diskutim

12.30-14.00 Drekë

14.00 Paneli i dytë: Veriu i Kosovës: PERSPEKTIVA ‘INVENTARIZUESE’ DHE E ‘SHIKIMIT PËRPARA’

Kryesues i panelit: Përfaqësuesi i Qendrës për Studime Ndërkombëtare (Universiteti i Oksfordit)

Folësit:

Prof. Sumantra Bose

Shkolla e Londrës për Ekonomi dhe Shkenca Politike (LSE)

Nida Gelazis

Qendra Uilson, Uashington

Prof. Bruno Sergi

Universiteti i Mesinës

Dr. Mateo Ballester Rodriguez

Universiteti Complutense, Madrid

15.30-15.45 Pauzë për kafe

15.45-17.00 Diskutim

17.00-17.30 Përfundime

20.30 Darkë